

## **Përshkrimi i programit EKONOMIA dhe MENAXHMENTI:**

Struktura e programit përmban ligjerata që nga natyra ofrojnë një qasje integruese në tema të biznesit(menaxhmentit)dhe ekonomisë.

Qëllimi i këtij seminari është që studentët që njoftohen dhe ti kuptojnë mjedisin e biznesit, bazat e menaxhmentit, subjektet e biznesit dhe operacionet e tyre në kontekstin e menaxhimit strategjik, menaxhimit të projektit, burimet njerëzore, menaxhimin e përgjithshëm të cilësisë dhe menaxhimin e investimeve; si dhe me parimet themelore në të cilat do të bazohet puna e secilit menaxher të ardhshëm. Ndjekja e këtij seminari ka për qëllim që studentët të përfitojnë njohuri themelore nga fusha e funksioneve bazike në menaxhment si planifikimi, organizimi, koordinimi, motivi dhe kontrolli. Ndjekja e seminarit **EKONOMIA dhe MENAXHMENTI** pjesmarrësve do t'u mundësojë:

- T'i shpjegojnë problemet fundamentale ekonomike.
- T'i kuptojnë lidhjen kohezive midis makroekonomisë dhe mikroekonomisë.
- T'i diskutojnë qëllimet dhe instrumentet e makroekonomisë.
- Të kuptojnë dhe t'i sqarojnë ciklet ekonomike.
- Të mësojnë bazat e menaxhmentit, aftësitë dhe rolet menaxheriale dhe të aftësohen për to që të japin shembuj konkretë.
- Të aftësohen ta shohin këtë seminar si nevojë për fitimin e njohurive menaxheriale, të cilat do të jenë në kontekst të zbatimit në praktikë të asaj që kanë mësuar.
- Të mendojnë në mënyrë efikase që do t'u ndihmojë të përballen me problemet afariste në jetën e tyre te mëturjeshme.
- Të zhvillohet koncepti i të menduarit kritik.
- T'i përgatisë pjesmarrësit për pozitën e udhëheqësit në organizatat profitabile dhe jofitimprurëse.

### Literatura

1. Riki V. Griffin, Bazat e menaxhmentit, Geneks – Përkthime, Koçan
2. Gregory Mankiw, Principet ekonomike, - Geneks – Përkthime, Koçan
3. Ricard.L.Daft, Menaxhment - Geneks – Përkthime, Koçan
4. Izet Zeqiri, Bazat e menaxhmentit, Tetov, 2016
5. Anne Lawrence dhe James Weber, Biznesi dhe Shoqëria, 2008, USA
6. Besim Beqaj, BIZNESI NDËRKOMBËTAR, Universiteti i Prishtinës Fakulteti Ekonomik, 2015
7. Halil Kukaj, Biznesi Ndërkombëtar, Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, Prizren, 2017.
8. Bolander dhe Snell, Menaxhimi me resurset njerëzore, GENEKS Përkthime, - Koçan (në shqip dhe maqedonisht) 2011